REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.44/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Mejreme Memaj dhe Afrim Shala, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit A. M., me vendbanim në rr. "..." në Gjakovë, për shkak të veprës penale ngacmimi, nga neni 182, par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, nr.2023:086352, të datës 07.06.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.897/2023, të datës 23.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13 shkurt 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar kërkesa e mbrojtësit të dënuarit A. M. për mbrojtjen e ligjshmërisë, kurse anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, nr.2023:086352 datë 07.06.2023 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.897/2023 datë 23.10.2023, dhe çështje penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

I dënuari A. M. me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, nr.2023:086352 datë 07.06.2023, për veprën penale ngacmimi, nga neni 182 par.1 të KPRK-së, është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.897/2023, e datës 23.10.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të mbrojtësit të të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit A. M., avokati Korab Bokshi, nga Gj., për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve

esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe shkeljeve të tjera e të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore, me propozim që Gjykata supreme e Kosovës këto aktgjykime ti anulojë, ashtu që çështjen tia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me shkresën KMLP.II.nr.21/2024, e datës 26.01.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit A. M., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, par.1 lidhur me nenin 436, par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

- kërkesa është e bazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit në kërkesë thekson aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të qarta përkitazi me rrethanat rënduese duke përcaktuar në mënyrë të qartë të dhënat në lidhje me aktgjykimet me të cilat i njëjti është shpall fajtor, veprat penale për të cilat është shpall fajtor, nëse këto vepra janë kryer ndaj të dëmtuarës së njëjte dhe nëse janë kryer nga motivi i njëjte, aq me tepër kur ligjvënësi ka paraparë rehabilitimin ligjor, ndërsa duke pasur parasysh kohën kur është gjykuar dhe dënimet e shqiptuara të dënuarit nuk mund ti merret rrethanë rënduese e kaluara e tij kriminale, ngase rehabilitimi ligjor është institut i së drejtës që ka paraparë pushimin e pasojave juridike në raport me të dënuarin.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e lartcekura janë të bazuara.

Kjo për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, par.2, nënpar.2.7 lidhur me nenin 369, par.6 dhe 8 të KPP-së, ndërsa këto shkelje nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Sipas dispozitës së nenit 369 par.6 të KPP - Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, kurse sipas par.8 të këtij neni kur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar duke u bazuar në këto dispozita ligjore, pasi që në pjesën e arsyetimit nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme rrethanat rënduese që janë marrë për bazë me rastin e caktimit së dënimit.

Kështu, nga arsyetimi i aktgjykimit së shkallës së parë del se gjykata e ka vlerësuar si rrethanë rënduese faktin se i pandehuri ka qenë i dënuar më parë nga kjo gjykatë dhe atë:

I. Sipas lëndës P.nr.276/2006 neni 229, i plotfuqishëm më datë 09.07.2008, i dënuar me kusht 4 (katër) muaj, për një viti; II. Sipas lëndës P.nr.74/2007,neni 229, i plotfuqishëm më datë

13.09.2011, i dënuar me dënim me burgim prej 1 (një) muaj dhe dënim me gjobë në shumën prej 100 (njëqind) euro, III. Sipas lëndës P.nr.501/2006, neni 253, i plotfuqishëm më datë 13.10.2009, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj; IV. Sipas lëndës P.nr.467/2007, neni 253, i plotfuqishëm më datë 28.02.2012, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj; V. Sipas lëndës P.nr.596/2008, neni 253, i plotfuqishëm më datë 24.05.2012, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj; VI. Sipas lëndës P.nr.222/2008, neni 252, i plotfuqishëm më datë 28.07.2011, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh; VII. Sipas lëndës P.nr.79/2007, neni 253, i plotfuqishëm më datë 29.05.2013, i dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj për 2 vite; VIII. Sipas lëndës P.nr.44/2009, neni 253, i plotfuqishëm më datë 03.11.2014, i dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muaj për 2 vite; IX. Sipas lëndës P.nr.290/2009, neni 253, i plotfuqishëm më datë 21.07.2014, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj; X. Sipas lëndës P.nr.284/2012, neni 253, i plotfuqishëm më datë 24.02.2015, i dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj; XI. Sipas lëndës P.nr.545/2015, neni 275, i plotfuqishëm më datë 29.07.2016, i dënuar me gjobë në shumën prej 100 (njëqind) euro, me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një) viti për 2 vite; XII. Sipas lëndës PKR.nr.423/2009, neni 275, i plotfuqishëm më datë 20.11.2013, dënuar më gjobë 400 (katërqind) euro; XIII. Sipas lëndës PKR.nr.119/2015, neni 275, i plotfuqishëm më datë 10.05.2016, i dënuar me gjobë në shumën prej 300 (treqind) euro; XIV. Sipas lëndës PKR.nr.49/2017, neni 275, i plotfuqishëm më datë 29.09.2017, i dënuar me gjobë në shumën prej 600 (gjashtëqind) euro; XV. Sipas lëndës P.nr.507/2018, neni 313, i plotfuqishëm më datë 17.07.2019, i dënuar me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) euro, dhe dënim me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një) viti muaj për 2 vite; XVI. Sipas lëndës P.nr.521/2012, neni 253, i plotfuqishëm më datë 06.04.2015, i dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një) viti për 2 vite; XVII. Sipas lëndës P.nr.16/2020, neni 269, i plotfuqishëm më datë 28.08.2020, i dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj për 1 (një) viti; XVIII. Sipas lëndës P.nr.159/2003, neni 252, i plotfuqishëm më datë 30.05.2006, i dënuar me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj për 1 (një) viti.

Nga arsyetimi del qartë gjykata e shkallës së pare e ka vlerësuar edhe aktgjykimet me të cilat janë bërë të plotfuqishme në vitin 2008, 2009, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, aktgjykime këto që nga plotfuqishmëria e të cilave ka kaluar një kohë e gjatë, dhe bazuar në dënimet e shqiptuara nuk përjashtohet mundësia që të jetë arritur rehabilitimi ligjor, dhe nuk mund te vlerësohen si të tilla në kuadër të të kaluarës kriminale të dënuarit, ngase për të tilla raste personi nuk konsiderohet i dënuar.

Përveç kësaj, sipas dispozitës së nenit 69 par.4 të KPRK-së është parashikuar se *"*Kur cakton dënimin për recidivistin, gjykata posaçërisht merr parasysh nëse kryesi më parë ka kryer vepër penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse të gjitha veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe kohën e kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm apo nga dënimi i mbajtur ose i falur".

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë është dashur që të jetë më e qartë në lidhje me të kaluarën penale të të dënuarit A. M., duke përcaktuar në mënyrë më të hollësishme dhe të qartë të dhënat në lidhje me aktgjykimet me të cilët i njëjti është shpallur fajtor; dhe të mos theksoj dënime të cilat mund të jenë shlyer nga evidenca.

Meqë aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat nuk janë evituar as me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet t'i evitojë të gjitha shkeljet e lartcekura, duke siguruar të dhëna të sakta në lidhje me të kaluarën penale të dënuarit, e pastaj të marrë një vendim të drejtë në këtë çështje.

Nga arsyet që janë theksuar më lart dhe në bazë të nenit 438, par.1, nënpar.1.2 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
Pml.nr.44/2024, më 13 shkurt 2024

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Rasim Rasimi